

KOMENTE TË PËRGJITHSHME

Mbi raportin e monitorimit të

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME

për tremujorin e tretë të vitit 2014

Misioni.

Ministria e Punëve të Jashtme formulon, përpunon dhe është zbatuesi kryesor i politikës së jashtme të Shtetit shqiptar, në zbatim të programit të qeverisë. Në dialog dhe marrëdhënie me të gjithë partnerët ndërkombëtarë, MPJ pasqyron të gjitha zhvillimet në Shqipëri, përfaqëson e mbron interesat kombëtare, si dhe punon për interesat e shtetasve shqiptarë kudo që ata ndodhen, në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqenies së tyre. Shërbimi i jashtëm i Republikës së Shqipërisë synon rritjen e rolit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe ato rajonale, si dhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në aktet ndërkombëtare.

Vështrim i përgjithshëm

Në respekt të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Ministria e Punëve të Jashtme, për vitin 2014, administron dhe menaxhon fondet publike sipas tre programeve të miratuara buxhetore, e konkretisht:

- Programi “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”
- Programi “Mbështetje diplomatike jashtë vendit”
- Programi “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ”

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Ministria e Punëve të Jashtme mbi monitorimin e buxhetit për tremujorin e tretë të vitit 2014, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi i Thesarit, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë ministri paraqitet si më poshtë:

	Emërtimi	Plani 2013	Fakti 2013	Plani / Totali	Fakti / Totali	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	2,140,000	1,493,063	99%	99%	69.8%
1.1	Personeli	842,000	621,923	39%	41%	73.9%
1.2	Operative	1,298,000	871,140	60%	58%	67.1%
2	Shpenzime kapitale	18,759	14,550	1%	1%	77.6%
2.1	Financim i brendshëm	18,759	14,550	1%	1%	77.6%
2.2	Financim i huaj	0	0	0%	0%	#DIV/0!
3	SHUMA	2,158,758	1,507,613	100%	100%	69.8%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		0	0%	0%	
4	TOTALI	2,158,758	1,507,613	100%	100%	69.8%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse evidentohet nga tabela, shpenzimet korente përbëjnë 99% të fondeve të planifikuara vjetore, por edhe të shpenzimeve faktike të regjistruara për periudhën 9-mujore. Investimet, përbëjnë vetëm 1% të buxhetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2014.

Masa e realizimit 9-mujor të buxhetit të vitit 2014 kundrejt buxhetit vjetor të miratuar është rreth 70 përqind. Në total, realizimi i shpenzimeve të korente renditet në rreth 69.8 për qind ndërkohë që shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 77.6%, në harmoni me pritshmërinë e periudhës së raportimit.

Ndërkohë, të dhënat sipas programeve buxhetore jepen në tabelën e mëposhtme. Sipas të dhënave, konstatohet se programi i aparatit të MPJ, rezulton me një realizim të shpenzimeve vetëm në nivelin 33.6 përqind si pasojë edhe e realizimit ulët të shpenzimeve korente dhe kapitale. Ndërkohë, dy programet e tjera shfaqin një performancë të mirë, në raport me planin e shpenzimeve të periudhës, me rreth 72 për qind respektivisht. Investimet e planifikuara në programin “Mbështetja Diplomatike Jashtë Vendit”, janë realizuar plotësisht në masën 100 për qind të planit vjetor.

Emërtimi i Programit	SHPENZIMET KORENTE			SHPENZIMET KAPITALE			TOTALI I SHPENZIMEVE		% realizimi
	PLAN	FAKT	% Realiz.	PLAN	FAKT	% Realiz.	Plan	Fakt	
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	120,500	38,220	31.7	9,759	5,550	56.9	130,258	43,769	33.6
Mbështetje Diplomatike Jashtë Vendit	1,763,500	1,270,376	72.0	9,000	9,000	100.0	1,772,500	1,279,376	72.2
Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MPJ-se	256,000	184,467	72.1	0	0		256,000	184,467	72.1
TOTALI	2,160,000	964,055	44.6	18,759	5,660	30.2	2,178,758	969,715	44.5

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme për çdo program sipas buxhetit të vitit 2014, dhe realizimit faktik i tij jepet në tabelën e mëposhtme.

Kodi	Emërtimi i Programit	Plani Fillestar	Plani me ndryshime	Realizimi
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	4.9	6.0	2.9
01120	Mbështetje diplomatike jashtë vendit	83.2	82.1	84.9
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	11.9	11.9	12.2
	TOTALI	100.00%	100.00%	100.00%

Burimi: Ministria e Financave

Rreth 85 përqind e totalit të shpenzimeve faktike të kryera për 9-mujorin e vitit 2014, përbëhet nga shpenzimet për programin “Mbështetje diplomatike jashtë vendit”, ndjekur nga shpenzimet për programin “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ” me rreth 12 përqind, dhe në fund shpenzimet për programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” me rreth 3 përqind.

MONITORIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

1. Programi “Planifikim, menaxhim, administrim”.

Ky program buxhetor, përgjithësisht përfshin shpenzimet për aparatën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, dhe synon mbështetjen financiare dhe njerëzore në realizimin e politikave në tërësi të drejtorive të MPJ duke siguruar një lidhje efikase ekonomike dhe financiare midis aparatit qendror dhe përfaqësive diplomatike. Më tej, synohet sigurimi i pasqyrimit të aktivitetit diplomatik në të gjitha platformat mediatike; trajtimi zyrtar i delegacioneve të huaja brenda dhe jashtë vendit nga protokoli i shtetit; si dhe administrimi i pasurive dokumentare arkivore për shfrytëzimin e saj nga strukturat e shërbimit të jashtëm dhe nga publiku.

Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson 2.9 përqind të totalit të shpenzimeve të periudhës 9-mujore. Sipas zërave, krahasuar me planin vjetor, realizimi paraqitet më poshtë.

01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	Plani	Fakti	Plani / Totali	Fakti / Totali	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	120,500	38,220	92.5%	87.3%	31.7%
1.1	Personeli	48,500	15,193	37.2%	34.7%	31.3%
1.2	Operative	72,000	23,027	55.3%	52.6%	32.0%
2	Shpenzime kapitale	9,759	5,550	7.5%	12.7%	56.9%
2.1	Financim i brendshëm	9,759	5,550	7.5%	12.7%	56.9%
2.2	Financim i huaj	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	130,258	43,769	100.0%	100.0%	33.6%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse evidentohet edhe në tabelën e mësipërme, shpenzimet e funksionimit të aparatit të MPJ-së, planifikohen në nivelin 130,3 milion lek, ndërkohë që për periudhën 9-mujore janë shpenzuar vetëm 33.6% e këtyre fondeve, ose 43.7 milion lek.

Për vitin 2014, fondet prej 130.3 milion leksh të këtij programi, janë parashikuar për realizimin e 11 produkteve buxhetore, nga të cilat 10 rezultojnë pjesërisht të realizuara dhe 1 nuk është realizuar ende, si pasojë e vazhdimit të procesit të prokurimit. Në tërësi, niveli i performancës për këtë program nuk është i kenaqshëm, dhe kërkohet angazhimi i MPJ-së për një performancë më të mirë në këtë drejtim.

2. Programi “Mbështetje diplomatike jashtë vendit”.

Ky program buxhetor përfshin të gjitha fondet e alokuara për sigurimin e tërësisë së funksioneve dhe shërbimeve që ofrojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore jashtë vendit, në përputhje të plotë me normat e të drejtës ndërkombëtare, në zbatim të programit të politikës së jashtme të Qeverisë Shqiptare si dhe në respekt të Kushtetutës së RSH. Më tej, programi synon nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit të gjithanshëm,

mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare e shtetërore dhe përkujdesin për interesat e qytetarëve shqiptarë në shtetet dhe organizatat ndërkombëtare ku ato janë akredituar.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën e 9-mujorit të vitit 2014 në këtë program, sipas zërave kryesor krahasuar me planin vjetor paraqiten si më poshtë.

0112 0	Mbeshtetje Diplommatike Jashte Vendit	Plani	Fakti	Plani / Totali	Fakti / Totali	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	1,763,500	1,270,376	99.5%	99.3%	72.0%
1.1	Personeli	608,500	485,039	34.3%	37.9%	79.7%
1.2	Operative	1,155,000	785,336	65.2%	61.4%	68.0%
2	Shpenzime kapitale	9,000	9,000	0.5%	0.7%	100.0%
2.1	Financim i brendshem	9,000	9,000	0.5%	0.7%	100.0%
2.2	Financim i huaj	0	0	0.0%	0.0%	#DIV/0!
3	SHUMA	1,772,500	1,279,376	100.0%	100.0%	72.2%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Ky program përfaqëson rreth 85 për qind të totalit të shpenzimeve 9-mujore të këtij institucioni, ose 1.27 miliard lek. Sikurse evidentohet nga tabela e mësipërme, shpenzimet korente përbëjnë 99.5% të totalit të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2014 për këtë program buxhetor, por edhe 99.3% të shpenzimeve faktike. Shpenzimet për personelin përbëjnë 34% të totalit të planit të programit, ndërkohë që shpenzimet e tjera operative përbëjnë pjesën tjetër prej rreth 65%. Shpenzimet kapitale, paraqiten në nivele minimale në këtë program, në vetëm 0.5% të buxhetit të miratuar. Pavarësisht vlerës së ulët të investimeve në krahasim me shpenzimet korente, ato paraqesin një nivel realizimi prej 100% të planit vjetor që në tremujorin e tretë të vitit. Në tërësi, programi paraqet një performancë të kënaqshme prej rreth 72% në terma vjetore.

Për vitin 2014 në këtë program janë parashikuar 5 produkte. Produktet që i përkasin pjesës operative të programimit janë realizuar në përputhje me buxhetin e planifikuar. Lidhur me shpenzimet kapitale, produkti i blerjes së pajisjeve të zyrave dhe apartamenteve për përfaqësitë diplomatike dhe blerja e pajisjeve informatike është realizuar plotësisht.

3. Programi “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ”

Ky program buxhetor, përmban fondet e dedikuara nga Ministria e Punëve të Jashtme për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave kombëtare dhe të shtetasve shqiptar, në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqënies së tyre, nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe si dhe ofrimit të shërbimit konsullor. Më specifikisht, ky program buxhetor ka për qëllim zgjerimin, intensifikimin, diversifikimin, thellimin dhe pasurimin e marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjikë, në rajon, Europë, dhe vende të tjera të botës.

Krahasuar me zërat e planit vjetor, realizimi i shpenzimeve në këtë program, i cili përfaqëson rreth 12.2 përqind të totalit të shpenzimeve 9-mujore të institucionit, rezulton si më poshtë:

01130	Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MPJ-se	Plani	Fakti	Plani / Totali	Fakti / Totali	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	256,000	184,467	100.0%	100.0%	72.1%
1.1	Personeli	185,000	121,691	72.3%	66.0%	65.8%
1.2	Operative	71,000	62,776	27.7%	34.0%	88.4%
2	Shpenzime kapitale	0	0	0.0%	0.0%	
2.1	Financim i brendshëm	0	0	0.0%	0.0%	
2.2	Financim i huaj	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	256,000	184,467	100.0%	100.0%	72.1%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Për vitin 2014 në këtë program janë parashikuar 15 produkte, të cilat përgjithësisht janë realizuar në harmoni me planin vjetor të shpenzimeve. Gjithsesi, në mënyrë që të evidentohet në mënyrë më specifike statusi i cdo produkti, Ministria e Punëve të Jashtme duhet të plotësojë anekset e raportit të monitorimit duke përdorur edhe planin e periudhës, dhe jo vetëm planin vjetor. Nëse merret plani vjetor, natyrisht që të gjithë produktet do të paraqiten me realizim të pjesshëm, ndërkohë që krahasimi duhet të bëhet edhe për periudhën referuese.

KRAHASIMI I TË DHËNAVE TË SHPENZIMEVE FAKTIKE

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e shpenzimeve faktike të raportit të hartuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, të krahasuara me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit në Ministrisë së Financave.

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	MPJ	MF	Dif	MPJ	MF	Dif	MPJ	MF	Dif
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	38,220	38,220	0	5,550	5,550	0	43,769	43,769	0
Mbeshtetje Diplomatike Jashte Vendit	1,270,376	1,270,376	0	9,000	9,000	0	1,279,376	1,279,376	0
Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MPJ-se	184,467	184,467	0	0	0	0	184,467	184,467	0
TOTALI	1,493,063	1,493,063	0	14,550	14,550	0	1,507,613	1,507,613	0

Burimi: Ministria e Financave, MPJ, të dhënat në mijë lek

Ashtu sikurse paraqitur në tabelën e mësipërme, të dhënat e përdorura nga MPJ për përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për tremujorin e tretë të vitit 2014, përputhen plotësisht me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit.

VOLUMI DHE MADHËSIA E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Për programet buxhetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Kodi	Emërtimi i Programit	Plani Fillestar	Plani me ndryshime	Diferenca
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	105,600	120,500	14,900
01120	Mbështetje diplomatike jashtë vendit	1,792,500	1,763,500	-29,000
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsulor i MPJ	256,000	256,000	0
	TOTALI	2,154,100	2,140,000	-14,100

Burimi: Ministria e Financave, MPJ, të dhënat në mijë lek

Ndryshimet prej 14.1 milion lek në planin e buxhetit, shpjegohen me ndryshimet në fondet e MPJ-së si pasojë e zbatimit të Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për ndryshimin e fondeve buxhetore gjatë vitit.

KOMENTE TË TJERA

- Duke vlerësuar përpjekjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, sjellim në vëmendje që në raportin e monitorimit, duhet të përfshihet më tepër informacion mbi realizimin e produkteve të programeve buxhetore, të cilat gjithashtu duhet të jenë të lidhura edhe me realizimin e objektivave të politikës së programit.
- Gjithashtu, kërkohen më tepër përpjekje në drejtim të përmirësimit të objektivave dhe produkteve buxhetore, emërtimeve të tyre dhe njësive matëse mbi bazën e të cilave monitorohet performanca e përdorimit të burimeve financiare publike.

Publikimi në faqen e internetit

Ministria e Punëve të Jashtme nuk ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportin e monitorimit të buxhetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014.